UDHËZIM
Nr. 595, datë 1.8.2019

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 12.092 (dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.
2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Udhëzimi nr. 627, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu